REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 18 datë 13.08.2026

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: "STRUKTURA AKOMODIMI DHE SHËRBIMI EKOLOGJIKE 1K DHE 2K, "NATYRA E QETË" AGROTURIZËM", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË VAU I DEJËS

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Dritan Canaj" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Struktura akomodimi dhe shërbimi ekologjike 1 dhe 2 kate, "Natyra e Qetë" agroturizëm", me vendndodhje në Bashkinë Vau i Dejës, me subjekt zhvillues shoqërinë "Dritan Canaj" sh.p.k.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij

3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 27 /10/ 2026